



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE**  
**SEKTORI I SHËRBIMEVE JURIDIKE**

**Mbi procedurën dhe dokumentacionin e kërkuar për ndryshimin e gjeneraliteteve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.**

Studentët të cilët ndjekin një nga ciklet e studimit të ofruara nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në rast se janë të interesuar për ndryshimin e gjeneraliteteve, si pasojë e veprimeve administrative të ndryshimit të gjeneraliteve sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi (celebrim, ndryshim i gjeneraliteteve me vendim gjykate apo nga organet kompetente, etj.) bazuar në nenin 61 e vijues të Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, duhet të depozitojnë dokumentacionin dhe të ndjekin procedurën si më poshtë:

- Hartimi dhe depozitimi në Rektorat i një kërkesë me shkrim për ndryshimin e gjeneraliteteve, ku të përshkruhet arsyeja e ndryshimit dhe gjeneralitetet e sakta që do të vendosen në dokumentacionin shkollor dhe diplomë.

Bashkëlidhur kësaj kërkesë studenti duhet të vendosë dokumentat e mëposhtme:

1. Vërtetim studenti i lëshuar brenda 3 (tre) muajve të fundit nga fakulteti ku ndjek studimet;
2. Fotokopje e dokumentit të identifikimit (Letërnjoftim ose Pasaportë me gjeneralitet e reja);
3. Certifikatë martese e lëshuar brenda 3 muajve të fundit (në rast celebrimi);
4. Vendim gjykate për zgjidhje martese (dokument orgjinal ose i njësuar me orgjinalin pranë një noteri);
5. Apo dokumenta të tjerë që sipas legjislacionit në fuqi janë lëshuar nga organet kompetente dhe vërtetojnë ndryshimin e gjeneraliteteve të studentit;

Pasi dokumentacioni depozitohet fizikisht në Zyrën e Protokoll - Arkivës në Rektorat dhe pas shqyrtimit nga struktura përkatëse, i përcillet fakultetit përkatës për pasqyrimin e tyre në dokumentacionin shkollor dhe diplomë.